



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

V E N D I M

Nr. 15, datë 17.06.2025

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT FLORIAN BALLHYSA NË VENDIN VAKANT, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË MË DATË 11.12.2024

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Illir Toska	Anëtar
Alma Muça	Anëtare
Elvana Çiçolli	Anëtarzëvendësuese
Enkela Vlora	Anëtare relatore
Irma Balli	Anëtare
Genti Xholi	Anëtarzëvendësues
Besart Kaçkini	Anëtarzëvendësues

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu, në prani të Avokates së Popullit, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e datës 17.06.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Florian Ballhysa

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 11.12.2024.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Enkela Vlora, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Informacion i përgjithshëm mbi kandidaturën dhe caktimin e relatorit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 11.12.2024, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.

2. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Gjykata e Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidati Florian Ballhysa, së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Në datë 15.01.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), realizoi procedurën e shortit për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjodh anëtarja Enkela Vlora, ndërsa këshilltare ligjore Iva Zemani.

4. Në datë 17.01.2025, kandidati Florian Ballhysa u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së. Gjithashtu në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar; si dhe Vendimin nr.4, datë 11.3.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, kandidati Florian Ballhysa i është njoftuar dhe emri i relatores dhe këshilltares së caktuar.

5. Në datën 17.01.2025, kandidati Florian Ballhysa në rrugë elektronike, konfirmoi marrjen e njoftimit dhe deklaroi se nuk ka dijeni për shkaqe papajtueshmërie si me relatoren dhe këshilltaren.

6. Në datë 20.01.2025, kandidati Florian Ballhysa, u paraqit pranë KED-së dhe tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimet e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, midis të cilave edhe ato për deklarimin e pasurisë dhe interesave financiarë. Në datë 21.01.2025, kandidati është paraqitur pranë KED për dorëzimin e autorizimeve dhe deklarimeve përkatëse.

II. Verifikimi i kushteve dhe kritereve kushtetuese dhe ligjore të kandidimit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

A. Procesi i deklarimit dhe kontrolli i pasurisë së kandidatit dhe familjarëve të tij sipas ligjit.

7. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, të nenit 7/a pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 8577/2000, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr.64 prot, datë 29.01.2025, Këshilli i ka dërguar, ILDKPKI-së, listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procesit të kontrollit të pasurive, interesave financiarë dhe konfliktin e interesave, sipas të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367/2005.

8. Bashkëlidhur kësaj shkrese të drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është përcjellë dhe “Deklarata” e nënshkruar nga kandidati Florian Ballhysa, në të cilën tregohet/konfirmohet se është pajisur me formularët përkatës të deklarimeve dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, dhe që mban datën 20.01.2025 të nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

9. Në zbatim të nenit të nenit 235 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, të nenit 7/a pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 8577/2000, dhe pikës 61 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, si dhe përcaktimeve të neneve 3/1, 4 pika 2 e vijues të ligjit 9049/2003, kandidati Florian Ballhysa ka plotësuar në mënyrë elektronike dhe ka dorëzuar të printuar e nënshkruar, brenda 15 ditëve, pranë ILDKPKI-së, Deklaratën e *“pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”*, të konfirmuar nga kjo e fundit me shkresën nr.766/1, datë 17.02.2025.

10. ILDKPKI-ja, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 4 të datës 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi ka kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit, me shkresën nr. 766/5 prot., datë 18.04.2025 ka përcjell aktin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, Florian Ballhysa për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, me nr. 17/23 prot, datë 18.04.2025, ku është konkluduar se, për kandidatin Florian Ballhysa:

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave;

B. Procesi i deklarimi dhe kontrolli i integritetit të kandidatit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

11. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 66 prot., datë 31.01.2025 dhe shkresën nr. 74, datë 31.01.2025, Këshilli Emërimeve në Drejtësi ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Florian Ballhysa sipas ligjit nr. 138/2015.

12. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 206/11 prot., datë 12.02.2025, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: “...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim për shtetasit e tjerë të cituar në shkresën tuaj, nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO”.

13. Nga ana e Drejtorisë së Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit të Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025, është bërë me dije, si vijon: “...Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimin e thelluar të të dhënave të vetëdeklaruar në formularin e plotësuar nga subjekt të këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi përgjegjës, për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, vetëm për rastet kur ky i fundit, pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak të të dhënave, konstaton se:

-subjekti/personi nuk ka deklaruar në formular asnjë fakt që ka të bëjë me të kaluarën e tyre penale, por ka indicie mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me....

-subjekti/personi ka deklaruar në formular të dhëna që kanë të bëjnë me rrethanat/faktet e sipërpërmendura dhe se prima facia të dhënat nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, por e kalon rastin për kontroll të thelluar, për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve, sipas ligjit;

-ka kërkesë të bërë pranë tij, si organ kompetent për verifikim të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Sipas kësaj dispozite, për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, të drejtën e nismës për të kërkuar verifikimin e të dhënave, pranë organit kompetent për verifikim, sipas këtij ligji, e ka 1/10 e deputetëve, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Në këtë rast, organi përgjegjës dhe kompetent, për administrimin e formularit dhe verifikimin paraprak të të dhënave, në kërkesën për verifikim të thelluar specifikon subjektin e nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 që ka kërkuar verifikimin dhe të dhënat, faktet apo rrethanat që përmban kërkesa e tij e që përbëjnë shkak për zbatimin e këtij ligji.....Për sa më sipër, mbështetur në nenet 44, 62 e 64 të Kodit të Procedurave Administrative, ju kërkohet plotësimi i pasaktësive/ të metave brenda njëzetë ditëve.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Mosplotësimi i tyre brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës". Në vijim të shkresës nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025 të Prokurorisë së Përgjithshme, është përcjell nga ky institucion me shkresën nr. 206/17 prot., datë 07.03.2025, vendimi i datës 07.03.2025 "Për mospranimin e kërkesës" ku është vendosur: "1. Mospranimin e kërkesës nr.66 prot., datë 31.01.2025, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për verifikimin e plotë të të dhënave të pasqyruara në formularin e vetedeklarimit datë 20.01.2025 në zbatim të ligjit nr. 138/2015, nga Florian Enver Ballhysa, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. 2. Ky vendim t'i njoftohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kundër të cilit mund të ankohet sipas procedurës së parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative".

14. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Florian Ballhysa, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si organi kompetent i administrimit të vetëdeklarimeve dhe zbatimin e ndalimeve për kandidatin, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion:

- me shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka kthyer përgjigje se: "...rezultojnë pa shënime në sistem...";
- me shkresën nr. 73 prot., datë 31.01.2024, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile e cila me shkresën nr. 1166/1 prot., datë 12.02.2025, ka kthyer përgjigje se: "Nuk ka ndryshime".
- me shkresën nr. 68 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila me shkresën nr. 543/4 prot., datë 10.02.2025, ka kthyer përgjigje se: "Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasit.... nuk janë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë veprë penale; nuk figurojnë të regjistruar me identitet tjetër; nuk rezultojnë të kthyer deportiv apo të dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër; nuk rezultojnë të kenë urdhër kërkimi ndërkombëtar nga ndonjë autoritet gjyqësor i huaj".

15. Gjatë procesit të verifikimit të kryer në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 e nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016, të pikave 79-87 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për këtë kandidat:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- nuk ka konstatuar asnjë të dhënë apo fakt, indicie mbi bazën e një kërkese, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me:
 - dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë, apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.
- nuk ka konstatuar të deklaruar anë formular të dhëna që kanë të bëjnë me faktet e sipërpërmendura apo të dhëna që *prima facie* të përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015;
- nuk ka konstatuar që të jetë kërkuar, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës, për verifikimin e të dhënave në Formularin e Vetëdeklarimit, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

C. Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

16. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Florian Ballhysa në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe nga informacionet e siguruar nga KED, zyrtarisht në kuadër të këtij procesi.

i. Kontrolli mbi gjendjen gjyqësore dhe proceset penale të regjistruar ndaj kandidatit (neni 7/a, pika 1 germa “ç” i ligjit nr. 8577/2000)

17. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Florian Ballhysa sikurse është cituar dhe më sipër në pikën 14 të këtij relacioni, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion, me *shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025*, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka kthyer përgjigje se: “...rezultojnë pa shënime në sistem...”.

18. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, me shkresën nr.206/11 prot., datë 12.02.2025, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: “...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim për shtetasit e tjerë të cituar në shkresën tuaj, nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO”.

19. Në vijim të shkresës nr. 66 prot., datë 31.01.2025 të KED, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 206/44 prot., datë 29.04.2025 është përcjell verifikimi i kryer nga prokuroritë e rretheve, ku evidentohet si vijon:

- Me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, lidhur me kandidatin referon: “Nuk rezulton të jetë regjistruar kallzime/referime/procedinte penale; Nuk rezulton i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprës penale si person i dyshuar; Nuk është ndaluar apo arrestuar në flagrance; Nuk i është caktuar ndonjë masë sigurimi personal”
- Me shkresën nr. 1068/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, lidhur me kandidatin referon: “... nuk është në hetim, apo i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale në Prokurorinë Dibër”.
- Me shkresën nr. 1383 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, lidhur me kandidatin referon: “.. nuk rezulton në hetim apo i dënuar me vendim të formës së prerë”.
- Me shkresën nr. 4377/1 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, lidhur me kandidatin referon: “nga verifikimet i kryer nga zyra e regjistrit dhe zyra e arkivës nuk rezulton të jetë regjistruar material kallëzues apo procedim penal..”.
- Me shkresën nr. 1297 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, lidhur me kandidatin referon: “Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi; Nuk është kërkuar masë sigurimi personal; Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim; Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale; Nuk ka pasur rast të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit”.
- Me shkresën nr. 4233 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, lidhur me kandidatin referon: “Nuk ka filluar ndjekje penale dhe nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë me kërkesën e kësaj Prokurorie”.
- Me email të datës 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka referuar se pas verifikimeve të bëra në regjistrat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nuk rezulton të jenë në hetim, apo jetë dhënë vendim gjykatë jo përfundimtar apo i formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale brenda territorit Republikës së Shqipërisë apo jashtë shtetit, në ngarkim të shtetasve sipas listës emërore, cituar në kërkesën.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Me shkresën nr. 7343 prot., datë 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lidhur me kandidatin referon: *“Nuk ka filluar ndjekje penale dhe nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë..”*
- Me shkresën nr. 2513 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, lidhur me kandidatin referon: *“nuk rezulton të jenë në hetim dhe nuk rezulton të jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale..”*
- Me shkresën nr. 1862/1 prot., datë 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, lidhur me kandidatin referon: *“nuk është regjistruar asnjë procedim penal”*.
- Me shkresën nr. 5380/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, lidhur me kandidatin referon: *“Prokuroria nuk ka në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë..”*
- Me shkresën nr. 3528 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, lidhur me kandidatin referon: *“nuk rezulton të jenë në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale..”*
- Me shkresën nr. 11061/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me kandidatin referon: *“Nga verifikimi i kryer në indeksat e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 2022-2025, nuk rezultoi të ketë procedim penal të regjistruar në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur”*.

20. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) me shkresat nr. 75 prot., - nr. 91 prot., datë 31.01.2025, ka kërkuar informacion pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Lartë. Në lidhje me kandidatin Florian Ballhysa, i cili renditet i pesti në listën e kandidatëve të përcjell për verifikim, gjykatat kanë përcjell informacionin vijues:

- Me shkresën nr. 611/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Lartë ka referuar: *“..nuk rezulton që pranë kësaj gjykate të ketë të regjistruar çështje penale në emër të shtetasve ... Florian Ballhysa..”*
- Me shkresën nr. 183/1 prot., datë ska, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përcillet informacioni se për kandidatin Florian Ballhysa rezulton se: *“..a. Nuk rezulton të jetë regjistruar për shqyrtim asnjë çështje penale në ngarkim të tyre; b. Nuk janë dhënë vendime penale qoftë të formës së prerë, apo jo, në ngarkim të tyre”*.
- Me shkresën nr. 396/1 prot., datë 10.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përcillet informacioni se për kandidatin Florian Ballhysa rezulton se: *“Pas verifikimeve të kryera në sekretarinë e gjykatës, rezulton se në lidhje me shtetasit e sipërcituar nuk janë dhënë vendime penale si dhe aktualisht nuk kanë çështje penale në gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

- Me shkresën nr. 2283/1 prot., datë 04.02.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është evidentuar se: *“...për periudhën 2007-02.02.2025, nuk rezultojnë të regjistruara për shqyrtim/gjykuara çështje penale në ngarkim të shtetasve të mëposhtëm:...”*
- Me shkresën nr. 114/1 prot., datë 04.02.2025 të Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë është evidentuar se: *“...rezulton se kandidatët e sipër cituar, nuk kanë pasur çështje penale si dhe nuk kanë vendim penal të formës prerë ose jo ndaj tyre”*.
- Me shkresën nr. 212/1 prot., datë 04.02.2025 të Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Berat është evidentuar se: *“Sipas verifikimit në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk rezultojnë çështje penale të regjistruara pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në ngarkim të tetë shtetasve të listuar në listën bashkëlidhur të dërguar nga ana juaj”*.
- Me shkresën nr. 547/1 prot., datë 07.02.2025 e Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është evidentuar se: *“...nuk rezultojnë të kenë qenë apo të jenë aktualisht si palë ndërgjyqëse në vendime apo procese gjyqësore në shqyrtim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”*.
- Me shkresën nr. 225/1 prot., datë 04.02.2025 e Gjykatës të Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është evidentuar se: *“...nuk rezultojnë që këta shtetas të kenë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, apo të jetë marrë vendim për të zbatuar/revokuar /shuarje mase sigurimi me karakter personal ose pasuror,apo të kenë procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara vendime dënimi apo pafajësie.*
- Me shkresën nr. 1070/1 prot., datë 05.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është evidentuar se: *“...Nuk rezultojnë që për kandidatët..., të jenë regjistruar çështje penale apo të jenë dhënë vendime penale pranë kësaj gjykate në ngarkim të tyre apo të kenë çështje për shqyrtim”*.
- Me shkresën nr. 27 prot., datë 27.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është evidentuar se: *“...nuk është proceduar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.*
- Me shkresën nr. 464/1 prot., datë 10.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë është evidentuar se: *“...nga verifikimi i sistemit ICMIS nuk rezultojnë asnjë çështje gjyqësore...”*.
- Me shkresën nr. 162/1 prot., datë 10.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është evidentuar se: *“... nuk rezultojnë të ketë proces penal, të jetë duke u verifikuar, marr vendim zbatuar/revokuar/shuar masë sigurimi me karakter personal ose pasuror, apo të kenë vendime dënimi apo pafajësie, në ngarkim të tyre”*.
- Me shkresën nr. 109/1 prot., datë 06.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është evidentuar se: *“...nuk rezultojnë të ketë të dhëna për procedime penale të filluara apo vendime penale të formës së prerë ose jo në të cilat përmendet emri ...”*.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

- Me shkresën nr. 89/1 prot., datë 07.02.2025 e Gjykatës së të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është evidentuar se: *“..nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim...”*.
- Me shkresën nr. 211/1 prot., datë 10.02.2025 e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është evidentuar se: *“...Nga kërkimi i indekseve dhe sistemeve, për llogari të shtetasve ...Florian Enver Ballhysa..., nuk rezulton të kenë patur të regjistruar çështje penale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Po ashtu Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk rezulton të ketë dhënë vendime penale për shtetasit (me datëlindjet përkatëse) e mësipër listuar. Vendosim në vëmendjen tuaj se ky informacion nuk përmban të dhëna mbi çështje që përbëjnë sekret hetimor (përgjime apo gjykime të kësaj kategorie) si dhe vendime penale të gjykatës me objekt "Pushimin e çështjes penale", kur subjektit nuk i është regjistruar emri në regjistrin e procedimeve (gjykime paraprake me objekt "Pushimin e procedimit penal nr.../viti"), pasi nuk regjistrohet emri as në sistemet e gjykatës apo regjistrat e saj”*.
- Me shkresën nr. 467/3 prot., datë 19.02.2025 e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është evidentuar se: *“Nga verifikimi realizuar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Penale për periudhën viti 2002 (vit kur fillon Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Penal) deri në datën e kësaj shkrese, lidhur me shtetasit e sipërcituar nuk rezulton të jetë regjistruar ose dhënë ndonjë vendim themeli penale /masa sigurimi në ngarkim të tyre...”*.
- Me shkresën nr. 599/1, datë 11.02.2025 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka evidentuar: *“Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), dhe verifikimi i kryer në indeksat penale të administruara pranë Zyrës së Arkivës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nuk rezulton që pranë kësaj gjykate të jetë dhënë vendim penal i formës së prerë apo të jetë regjistruar për shqyrtim çështje penale..”*.

21. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me shkresën nr. 71 prot., datë 31.01.2025, i ka kërkuar informacion dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim SPAK), e cila, me shkresën nr. 7717 prot., datë 28.02.2025, ka kthyer përgjigje se:

*“Në përgjigje të shkresës suaj, me nr.71 prot, datë 31.01.2025, ardhur dhe protokolluar më datë 03.02.2025, ju konfirmojmë se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e procedimeve penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, **nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim** të kandidatëve të mëposhtëm, të cilët do të përfshihen në shortin për zgjedhjen si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese:.... 5. Kandidat Florian Enver Ballhysa, datëlindja 23.12.1978, nr. ID H81223099U...”*.

Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e kallzimeve.. Në lidhje me shtetasin Florian Ballhysa, rezultojnë këto të dhëna:

- *Ndaj shtetasit Florian Ballhysa, është regjistruar kallzimi Nr.38 i vitit 2022, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr.41, viti 2022, për veprat penale të parashikuara nga nenet 180 dhe 248, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar.*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr.31/152, vendimi, datë 16.02.2023, ka vendosur pushimin e procedimit Nr.41, viti 2022.

- *Ndaj shtetasit Florian Ballhysa, është regjistruar kallzimi Nr.63 i vitit 2022, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr.64, viti 2022, për veprat penale të parashikuara nga nenet 180 dhe 248, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar.*

Pas kryerjes së hetimeve të procedimit penal Nr.64, viti 2022 është vendosur bashkimi i këtij procedimi penal në një procedim të vetëm me numrin 41, viti 2022.

21.1 Konstatohet se bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhet vendimi nr. 31/152, datë 16.02.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (vendim i gjyqtarit të seancës paraprake), ku evidentohet se Prokuroria e Posaçme ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. 41/2022 me procedimin penal nr. 64/2022 në një procedim të vetëm me nr. 41/2022. Rezulton se në këtë vendim është vendosur: *“Pranimi i kërkesës së Prokurorit. Pushimi i çështjes penale nr. 41, datë regjistrimi 19.02.2022 për veprat penale të “Fshehjes së të ardhurave” dhe “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 180 dhe 248 të Kodit Penal për shkak se fakti i provuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale...”*. Vendimi nr. 31/152, datë 16.02.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas shënimit me vulën e kryesekretarisë, ka marrë formë të prerë në datë 07.10.2023.

22. Në vijim të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Florian Ballhysa, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi iu ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 67 prot., datë 31.01.2025 Autoritetit Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 72 prot., datë 31.01.2025, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (ish Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave) pranë Ministrisë së Brendshme.

23. Autoriteti Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1342 prot., datë 12.03.2025 ka evidentuar se: *“Në përfundim të procedurave të verifikimit, autoritetet verifikuese na informojnë se **nuk disponohen të dhëna** për përfshirjen e z. Florian Enver Ballhysa, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme. Për kandidatin e lartpërmendur, janë aplikuar standardet e parashikuara në nenin 38 "Standardet e kontrollit të figurës, të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

24. Ndërsa, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. 658/1 prot., datë 11.02.2025 ka evidentuar se: *“ **Nuk ka të dhëna** për kontakte apo lidhje të tyre me persona të papërshtatshëm apo të përfshirë në krimin e organizuar”*.

25. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 69 prot., datë 31.01.2025, Këshilli i ka dërguar, formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Florian Ballhysa, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

26. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, pas kontrollit të ushtruar, me shkresën nr. 308/5 prot., datë 14.02.2025, ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 71, datë 14.02.2025, me të cilën është konkluduar se:

“ , z. **Florian Ballhysa**,... **për shkak të moshës së tyre nën 14 vjeç përpara datës 2 korrik 1991 si datë fundore e zbatimit të ligjit 45/2015, nuk janë subjekte verifikimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar**”.

ii. Kontrolli mbi shtetësinë dhe zotësinë për të vepruar.

27. Neni 7/a pika 1 shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar. Kandidati Florian Ballhysa, me atësi Enver, amësi Hatlije, lindur më datë 23.12.1978 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me nr. personal H81223099U, sipas certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, rezulton me shtetësi shqiptare. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që kandidatin t’i jetë hequr apo t’i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

iii. Kontrolli mbi arsimin e kandidatit

28. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Florian Ballhysa ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1997 - 2001 si “Jurist”, në Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Në vijim gjatë periudhës 2005-2008 ka përfunduar studimet Master në Studime Evropiane pranë Shkollës Pasuniversitare të Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës. Në zbatim të nenit 75 dhe 124 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

iv. Kontrolli për ushtrim funksione politike/pozicione drejtuese në parti politike

29. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë *mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, ka miratuar ndryshimet në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të Drejtësisë”, duke bërë pjesë të tij “Formularin e vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”, i cili u botua në fletoren zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Këto ndryshime u kushtëzuan nga fakti se në praktikën e KED-së në vitet të mëparshme, partitë politike, nuk dërgonin informacionin e nevojshëm, duke ndikuar dhe vështirësuar marrjen e informacionit lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin e kandidatëve në ndonjë pozicion drejtues në parti politike. Në zbatim të këtij detyrimi kandidati Florian Ballhysa ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit datë 20.01.2025, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike. Gjithashtu rezulton se gjatë periudhës së verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë ndryshe, apo ndonjë informacion nga persona të tretë në lidhje me këtë fakt. Po ashtu, sillet në vëmendje se lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati “të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike.. gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”, nuk konstatohet që gjatë dhjetë viteve të fundit (pra nga vitit 2014 e në vijim) kandidati të ketë ushtruar funksione politike në administratën publike.

v. Kontrolli mbi përvojën profesionale të kandidatit në punë.

30. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike. Nga librezja e punës së kandidatit rezulton dokumentuar përvoja e punës si vijon:

15.gusht.2001 – 19.korrik.2002, *ICMC-Këshilltar Ligjor*;

27.gusht.2002 – 20.tetor 2002, *Sekretar i Zëvendësministrit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit*;

23.tetor 2002 – 12.shkurt.2003, *Sekretar i Zëvendësministrit, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve*;

30.mars 2004 – 16.mars 2005, *Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë*;

16. mars.2005 – 01.maj.2005, *Drejtor i Kabinetit të Ministrit*;

21.shkurt 2006 – 20.maj.2013, *Ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë*;

20.maj.2013 – 20.qershor.2013, *Këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese*;

26.nëntor.2013 - 14.shtator 2015, *Këshilltar juridik në Kuvendin e Shqipërisë*;

17.qershor.2017 – 31.dhjetor.2024, *Komisioner Publik, në Institucionin e Komisionerëve Publik*;

31. Në lidhje me verifikimin e kriterit të vjetësisë, masave disiplinore dhe përformancës në detyrë, në përputhje me kërkesat e nenit 7/a, pika 2 e Ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" KED ka çmuar të nevojshme të verifikoj për aq sa rezulton e mundur të gjitha marrëdhëniet e punës të dokumentuara në librezën e punës së kandidatit, rrjedhimisht i është drejtuar institucioneve pranë të cilave rezulton se kandidati ka ushtruar marrëdhëniet e punësimit sipas pasqyrimit në librezën e punës. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të vendimit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, pavarësisht të dhënave të pasqyruara nga librezat e punës, jetëshkrimi apo edhe dokumentacionit shkresor të paraqitur nga kandidati, Këshilli për shkak të kryerjes së një hetimi të thelluar në drejtim të këtij kriteri, ka kryer një korrespondencë shkresore me të gjithë institucionet ku kandidati Florian Ballhysa ka ushtruar veprimtari profesionale, duke kërkuar informacion për këto çështje: (i) marrjen e konfirmimit të periudhës kohore që ka ushtruar veprimtari profesionale pranë tyre; (ii) kërkimin e akteve të emërimit dhe të largimit nga detyra; (iii) konfirmimin dhe marrjen e të dhënave në lidhje me performancën në punë (masa disiplinore apo shkakun e largimit nga detyra); (iv) përshkrimin e detyrave funksionale dhe veprimtarinë ligjore që ka mbuluar në kryerjen e këtyre detyrave.

32. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë ICMC (Internacional Catholic Migration Commission), si Këshilltar Ligjor, me shkresën nr. 212 prot., datë 30.04.2024, KED i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke kërkuar informacion nëse subjekti ICMC (Albania Office), rezulton i regjistruar në regjistrin tregtar dhe konfirmimin e adresës dhe selisë së këtij institucioni brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Me shkresën nr. 3092/1 prot, datë 09.05.2025 është evidentuar: *“Nga verifikimet e kryera në regjistrin e organizatave jofitimprurëse rezulton se organizata jofitimprurëse ICMC - Komision Katolik Ndërkombëtar për Migracionin si degë e ICMC-së, është regjistruar me vendimin nr. 2091, datë 30.06.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Me vendimin nr. 2091/3, datë 06.07.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: Mbyllja e zyrës së përfaqësimit të ICMC "Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migracionin" në Shqipëri”.*

33. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit si sekretar i zëvendësministrit, pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, me shkresën nr. 2259 prot., datë 20.05.2025 Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor evidenton: *“Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor nuk disponon arkivën e ish Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për periudhën 2002. Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë se pas vitit 2005, ish Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit u integrua si pjesë e fushës së përgjegjësisë dhe strukturave të Ministrisë së Brendshme”.* Në vijim KED, me shkresën nr. 243 prot., datë 28.05.2025 i është drejtuar Ministrisë së Brendshme për verifikimin e kësaj periudhe punësimi. Nga librezat e punës së kandidatit rezulton se detyra e sekretarit të zëvendësministrit pranë ish Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit është ushtruar nga data 27.08.2002 deri në datën 20.10.2002 dhe shkakun e largimit nga detyra është për shkak të kalimit në detyrë tjetër. Me anë të shkresës nr. 3574/1, datë 16.06.2025, Ministria e Brendshme ka evidentuar se : *“Nga verifikimet në arkivin e Ministrisë së Brendshme, rezulton se nuk ka dosje personale të arkivuar, ku të jenë përfshirë të dhëna lidhur me vijueshmërinë e marrëdhënieve të punësimit, përshkrimin e natyrës së punës së ushtruar apo vlerësimet e performancës në detyrë për z. Ballhysa. Ndërkaq, sipas Regjistrit të Personelit, me numër rendor 249, z. Ballhysa ka ushtruar detyrën e Sekretarit të Zëvendësministrit për Pushtetin Vendor dhe Decentralizimin, në periudhën 27 gusht 2002-20 tetor 2002”.*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

34. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit si sekretar i zëvendësministrit, pranë Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, me shkresën nr. 6157, datë 09.05.2025 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit evidentohet si vijon:

“Z. Florian Enver Ballhysa, ka punuar pranë ish-Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në pozicionin sekretar Zëvendësministri, nga data 23.10.2002 dhe është larguar me dëshirën e tij nga pozicioni i punës në datën 12.02.2003.

Detyrat që ka kryer z. Ballhysa në pozicionin e Sekretarit të Zv/Ministrit, përfshijnë përgjegjësi administrative, organizative dhe mbështetëse për Zëvendësministrin në ushtrimin e funksioneve të tij. Detyrat tipike të kryera në këtë rol janë:

Menaxhimi i orarit të zëvendësministrit, përfshirë takime, udhëtime dhe aktivitete publike. Përgatitja dhe menaxhimi i korrespondencën hyrëse dhe dalëse (e-mail, shkresa zyrtare, njoftime etj.). Hartimi dhe përgatitja e dokumenteve për takime, raporte të brendshme ose komunikime zyrtare. Vepron si urë lidhëse ndërmjet zëvendësministrit dhe departamenteve të brendshme të ministrisë. Trajtimi i informacioneve të ndjeshme dhe konfidenciale me profesionalizëm të lartë. Ndihmon në përgatitjen e materialeve për projektet e zëvendësministrit (në fushat e kulturës, rinisë apo sportit). Planifikon logjistikën e udhëtimeve të zëvendësministrit (transporti, akomodimi, agjenda).

Konfirmojmë se gjatë vijueshmërisë së marrëdhënieve të punës ndaj z. Florian Ballhysa, nuk është marrë asnjë masë disiplinore..”

35. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën nr. 1159/1, datë 17.03.2025 të Ministrisë së Drejtësisë është evidentuar si vijon:

“Në vijim të shkresës suaj nr.141, datë 21.02.2025 "Kërkesë për informacion", depozituar në Ministrinë e Drejtësisë me nr.1159, datë 24.02.2025, ju bëjmë me dije se, sipas verifikimit të regjistrave të lëvizjeve të personelit dhe dokumenteve në Sektorin e Arkiv-Protokollit dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore, rezulton sa më poshtë: Z.Florian Enver Ballhysa, ka punuar në periudhat dhe pozicionet sa më poshtë: Nga data 30.03.2004-16.03.2005, Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë; Nga data 16.03.2005-01.05.2005, Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Drejtësisë”. Rezulton se bashkëlidhur shkresës gjendet urdhri nr. 1853, datë 24.03.2005 "Për emërimin në detyrë" përmes së cilit kandidati është emëruar Këshilltar në Kabinetin e Ministrit dhe urdhrin nr.1853/1, datë 06.05.2005 "Për lirim dhe emërim në detyrë" përmes së cilit kandidati lirohet nga detyra dhe emërohet Drejtor i Kabinetit të Ministrit. Po ashtu urdhri nr. 1853/1, datë 06.05.2005 përmes së cilit është liruar nga detyra kandidati.

36. Me shkresën nr. 207, datë 24.04.2025, KED i është ridrejtuar Ministrisë së Drejtësisë, sa i përket vlerësimeve të performancës në detyrë dhe nëse ndaj kandidatit janë marrë masa disiplinore. Po ashtu, me shkresën nr. 211, datë 30.04.2025, KED i është ridrejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar informacion mbi përshkrimin/klasifikimin e pozicionit të mbajtur nga kandidati pranë Ministrisë së Drejtësisë (kategoria/niveli). Lidhur me këtë kërkesë ka pasur edhe korrespondencë elektronike me Ministrinë e Drejtësisë, ku pas kërkesës së kësaj ministrie, KED, ka sqaruar se kërkohet informacion nëse kandidati ka qenë i punësuar në kategorinë e ulët/mesme/lartë ekzekutive, cilat kane qene detyrat funksionale te ushtruara prej tij si dhe kategoria e pagës sipas emërimit në detyrë, pasi këto të dhëna nuk ishin përcjell nga Ministria e Drejtësisë.

37. Me anë të shkresës nr. 2531 prot., datë 08.05.2025 Ministria e Drejtësisë ka evidentuar si vijon: *“Në vijim të shkresës suaj nr.207, datë 24.04.2025 "Kërkesë për informacion",*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

depozituar në Ministrinë e Drejtësisë me nr.1159/2, datë 25.04.2025, ju bëjmë me dije se, sipas verifikimit të regjistrave të lëvizjeve të personelit dhe dokumenteve në Sektorin e Arkiv-Protokollit dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore, për z.Florian Enver Ballhysa ... rezultojnë vetëm të dhënat që ju kemi përcjellë me shkresën nr.1159/1 datë 17.03.2025, pra nuk rezultojnë të dhëna të tjera”.

38. Me anë të shkresës nr. 1159/4 prot., datë 08.05.2025, Ministria e Drejtësisë ka evidentuar si vijon: “Në vijim të shkresës suaj nr.211, datë 30.04.2025 “Kërkesë për informacion”, depozituar në Ministrinë e Drejtësisë me nr.1159/3, datë 02.05.2025, ju bëjmë me dije se, sipas verifikimit të regjistrave të lëvizjeve të personelit dhe dokumenteve në Sektorin e Arkiv-Protokollit dhe Sektorin e Burimeve Njerëzore, për z.Florian Enver Ballhysa, rezultojnë vetëm të dhënat që ju kemi përcjellë me shkresën nr.1159/1, datë 17.03.2025, pra nuk rezultojnë të dhëna të tjera”.

39. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Gjykatës së Lartë si ndihmës ligjor, Gjykata e Lartë me shkresën nr. 968/1 prot., datë 21.02.2025, ka evidentuar si vijon:

“Në vijim të shkresës suaj të datës 14.02.2025, nr. prot 104, për marrje informacioni në kuadër të procedurës së verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për kandidatët të cilët kanë ushtruar funksionin e Ndihmësit Ligjorë në Gjykatën e Lartë, në bazë të dokumentacionit që disponon sektori i burimeve njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Gjykatës së Lartë, për kandidatët z.Florian Enver Ballhysa..., Ju informojmë se:

1. Nuk ka patur vlerësime të performancës në detyrë.

2. Nuk ka filluar/ janë marrë ndonjëherë masa disiplinore në ngarkim të tyre.

3. Në lidhje me vijueshmërinë e marrëdhënies së punës së kandidatëve në funksionet e ushtruara pranë Gjykata e Lartë Ju bëjmë me dije si vijon:

3.1 Florian Enver Ballhysa, i datëlindjes 23.12.1978, identifikuar me nr. personal H81223099U (ndihmës ligjorë).

Ka filluar detyrën e Ndihmësit Ligjor pranë gjyqtarit z.Fatos Lulo më 22/02/2006 sipas Urdhërit Nr.24, datë 21.02.2006 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Thimjo Kondi për "Emërim në detyrë" bazuar edhe në propozimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë z.Fatos Lulo, me pagë mujore të barabartë me pagën e gjyqtarit të gjykatës së apelit. Është liruar nga detyra sipas Urdhërit Nr.123, datë 24/05/2013 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Xhezair Zaganjori, për "Lirim nga detyra" e Ndihmësit Ligjor, 'ipso jure' njëkohësisht me mbarimin e mandatit të Anëtarit të Gjykatës së Lartë z. Fatos Lulo. Marrëdhëniet financiare i janë ndërprerë më datën 02/05/2013...

4. Në lidhje me detyrën/at funksionale të kandidatëve gjatë marrëdhënies së punës natyrën e punës së ushtruar prej tij/saj (me qëllim përcaktimin e ngarkesës së punës).

Bazuar në përcaktimet ligjore të kohës detyrat funksionale të ndihmësit ligjor përkonin me studimin e ankimeve, studimin e dosjeve gjyqësore, përgatitjen e relacioneve për çështjet në gjykim/shqyrtim duke dhënë mendimin/opinionin e tyre, u përgjigjeshin ankesave, përgatitnin materialet e nevojshme për shqyrtimin/gjykimin e çështjeve nga kolegjet përkatëse (civil, penal, administrativ), si dhe kryenin çdo detyrë tjetër që u ngarkohej nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë ku ndihmësit ligjor ishin atashuar.

Për sa më sipër Ju informojmë se:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

4.1 Kandidati Florian Enver Ballhysa kryente detyrat funksionale në kolegjin civil, pasi gjyqtari Fatos Lulo ku kandidati ishte atashuar ishte anëtar i Kolegjit Civil në Gjykatën e Lartë për periudhën 2005-2013”.

39.1 Data e përfundimit të marrëdhënieve të punës pranë Gjykatës së Lartë, sipas librezës së punës së kandidatit është data 20.05.2013 (*konstatohet se e njëjta datë është deklaruar edhe nga kandidati në jetëshkrimin e tij*). Rezulton se urdhri i Gjykatës së Lartë për lirimin e kandidatit nga detyra, mban datën 24.05.2013 (*ndërsa efektet financiare sipas urdhrit kanë përfunduar në datë 02.05.2013*). Si datë e përfundimit të marrëdhënies së punës së kandidatit do konsiderohet data që rezulton nga librezja e punës.

40. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Gjykatës Kushtetuese si këshilltar ligjor, Gjykata Kushtetuese, me shkresën nr. 162/1 prot., datë 28.02.2025 evidenton:

“1. Nga data 20.05.2013 deri në datën 20.06.2013 ka ushtruar detyrën e këshilltarit të gjyqtarëve Ndërrprerja e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare me Gjykatën Kushtetuese, në detyrën e këshilltarit të gjyqtarëve, është bërë me anë të kërkesës së tij me nr. 214 prot., datë 20.06.2013.

2. Detyrat funksionale të kandidatit gjatë marrëdhënieve të punës si këshilltar i gjyqtarëve kanë qenë:

a. ushtrimi i funksioneve ndihmëse e këshillimore në procesin vendimmarrës të Gjykatës;

b. dhënia e mendimit për çështjet;

c. përgatitja e opinioneve ligjore dhe hartimi i projektvendimeve mbi udhëzimet e gjyqtarit relator;

ç. përgatitja e materialeve kërkimore për çështjet;

d. kryerja e çdo detyre tjetër të caktuar nga gjyqtari relator, Kryetari ose Mbledhja e Gjyqtarëve, etj.

3. Nga verifikimi i të dhënave të dosjes personale, nuk rezulton që për kandidatin të ketë pasur vlerësime të performancës në detyrë.

4. Nga verifikimi i të dhënave të dosjes personale, nuk rezulton që ndaj kandidatit të ketë filluar ose të jetë marrë ndonjëherë masë disiplinore”.

41. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidatit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si këshilltar juridik, me shkresën nr. 610/2 prot., datë 19.02.2025 Kuvendi evidenton: “Në vijim të kërkesës suaj me nr. 105 prot, datë 14.02.2025, “Kërkesë për informacion”, për zotin Florian Enver Ballhysa në kuadër të procedurës së verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 228, pika 5 dhe të nenit 229 pika 4 të ligjit nr. 115/2016, po ju përcjellim informacionin e kërkuar si më poshtë vijon:

1. Aktin e emërimit pranë Institucionit të Kuvendit të Shqipërisë.

2. Aktin e liritimit nga Shërbimi Civil i Kuvendit të Shqipërisë.

3. Formularët e vlerësimit të punës për periudhën e punësimit në Kuvendin e Shqipërisë.

4. Vërtetimi për masat disiplinore”.

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme gjendet, vërtetimi nr. 19 prot., datë 19.02.2025, ku vërtetohet se: “..z. Florian Enver Ballhysa ka qenë nëpunës i Administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në pozicionin “Këshilltar juridik” në Shërbimin Juridik.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Për periudhën e punësimit në administratën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 26.11.2013-14.09.2015, nuk ka pasur asnjë masë disiplinore që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi”.

42. Konstatohet se Kuvendi ka vënë në dispozicion praktikë dokumentare që i referohet periudhës së punësimit të kandidatit pranë Kuvendit duke përfshirë si vijon:

a. Vendimi nr. 29, datë 26.11.2013 për emërimin e përkohshëm të një nëpunësi civil (në pozicionin këshilltar juridik, në Shërbimin Juridik, deri në përfundim të procedurave të konkurimit-paga sipas klasës II-b);

b. Vendimi nr. 29, datë 27.03.2014 për emërimin e një nëpunësi civil në administratën e Kuvendit (pozicionin këshilltar juridik, në Shërbimin Juridik);

c. Vendimi datës 28.04.2015, me nr. 1325 prot., për konfirmimin e nëpunësit civil, ku kandidati konfirmohet si nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese në detyrë “këshilltar juridik” në shërbimin juridik;

d. Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil datë 09.04.2015;

e. Vendimi nr.41, datë 19.09.2015 për lirim nga shërbimi civil, ku është vendosur: “të lirohet nga shërbimi civil i Kuvendit dhe detyra “këshilltar juridik” në Shërbimin Juridik z. Florian Ballhysa pasi ka dhënë dorëheqjen për arsye personale..’ (Gjithashtu janë bashkëlidhur akte për vlerësimin e periudhës së provës, certifikata të ASPA, formular vlerësim pune).

Me shkresën nr. 18 prot., datë 18.04.2025 Kuvendi ka evidentuar se: “z. Florian Enver Ballhysa ka qenë nëpunës i Administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në pozicionin “Këshilltar juridik” në Shërbimin Juridik. Për periudhën e punësimit në administratën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 26.11.2013-14.09.2015, nuk ka pasur asnjë masë disiplinore”.

43. Lidhur me detyrën e ushtruar nga kandidati si Komisioner Publik, në Institucionin e Komisionerëve Publik, me qëllimin verifikimin e vijueshmërisë së kësaj marrëdhënie pune, KED me anë të shkresës nr. 110 prot., datë 14.02.2025, i është drejtuar Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si organi që në mbështetje të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 70 të ligjit nr. 84/2016, tashmë ushtron funksionet e ish Komisionerëve Publik. Me anë të shkresës nr. 6741 prot., datë 21.01.2025, Prokuroria e Posaçme ka evidentuar si vijon: “Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në mbështetje të nenit 179/b, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga data 01.01.2025 ushtron kompetencën e Komisionerëve Publikë, pas shpërbërjes së tyre. Prokuroria e Posaçme nuk ka trashëguar asnjë dokumentacion arkivor të Institucionit të Komisionerit Publik, përveç dosjet/fashikujt e subjekteve të rivlerësimit të ankimuara dhe që ndodhen në pritje të shqyrtimit, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Në mbështetje të nenit 12, pika 1, paragrafi 2, të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", është përcaktuar që, “Për vitin 2025, për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj, për të finalizuar procesin e mbylljes së veprimtarisë administrative të Komisionerit Publik, një pjesë e numrit të punonjësve administrativë të këtyre institucioneve sipas vendimit të Kuvendit do të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë dhe do të jenë pjesë e programit buxhetor të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë”.

Sa më sipër, Prokuroria e Posaçme nuk disponon asnjë dokumentacion arkivor të organikës së institucionit të Komisionerëve Publikë, pjesë e të cilës kanë qenë dhe ... z. Florian Enver Ballhysa”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

44. Me shkresën nr. 201 prot., datë 15.04.2025, KED i ka kërkuar informacion Kuvendit në lidhje me vijueshmërinë e ushtrimit të detyrës së kandidatit si ish- Komisioner Publik në Institucionin e Komisionerëve Publik.

Kuvendi me shkresën nr. 1408/1 prot., datë 23.04.2025, evidenton:

“Z.Florian Ballhysa është zgjedhur në funksionin e Komisionerit Publik me vendimin nr.82 të Kuvendit të Shqipërisë, datë 17.6.2017, “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në nenin 179/b, pika 8, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: “Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024...”, mandati i z.Florian Ballhysa ka përfunduar më 31.12.2024”.

45. Në kohën e aplikimit, kandidati ndër të tjera ka dorëzuar shkresën me lëndë “kthim përgjigje” nr. 15/1 prot., datë 08.01.2025 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, ku pasqyrohet si vijon: *“Nga verifikimi i “Regjistrimit të ankesave dhe kërkesave në kuadër të juridiksionit disiplinor” në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, rezulton se prej fillimit të aktivitetit të tij, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor, ndaj Komisionerit Publik Florian Ballhysa, në kuadër të parashikimit të nenit 17 pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe si rrjedhojë nuk rezulton të ketë masë disiplinore në ngarkimin tuaj”*

46. Në datë 30.05.2025, KED i ka bërë me dije kandidatit në rrugë elektronike, se duke pasur parasysh veprimtarinë e tij profesionale, vlerësohet se përpara vendimmarrjes në lidhje me plotësimin e kriterit të parashikuar në nenin 7/a, pika 2 e Ligjit nr. 8577/2000, të njoftohet mbi të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve, brenda një afati 5 ditor si dhe dokumentacionit mbështetës, lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë së tij profesionale të sipërcituar me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000 dhe vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” ndryshuar me vendimin nr. 4, datë 23.11.2023, të KED.

46.1 Brenda afatit të caktuar nga relatorja, në datë 03.06.2025, kandidati ka depozituar në rrugë elektronike parashtrime me shkrim mbi qëndrimin e tij lidhur me përshtatshmërinë e funksioneve të ushtruara nga ana e tij me kërkesat e ligjit dhe aktit nënligjor. Në datë 04.06.2025, parashtrimet e kandidatit dhe provat bashkëlidhur i janë dërguar anëtareve të Këshillit. Kandidati ka vlerësuar se plotëson kriterin ligjor të përvojës profesionale sipas ligjit duke parashtruar ndër të tjera si vijon:

“..Më lejoni t’ju tërheq fillimisht vëmendjen lidhur me faktin se në jetëshkrimin tim, dorëzuar gjatë procesit të aplikimit dhe publikuar në pjesën e dedikuar të KED në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, është specifikuar se, për sa i takon plotësimin të kriterit profesional nga ana ime, është parashtruar vetëm përvoja profesionale për periudhat si vijon:

- 15 gusht 2001 – 19 korrik 2002, ICMC – Këshilltar Ligjor;
- 30 mars 2004 – 16 mars 2005, Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë;
- 16 mars 2005 – 1 maj 2005, Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Drejtësisë;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- 21 shkurt 2006 – 20 maj 2013, Ndhmës Ligjor në Gjykatën e Lartë;
 - 20 maj 2013 – 20 qershor 2013, Këshilltar Ligjor në Gjykatën Kushtetuese;
 - 26 nëntor 2013 – 14 shtator 2015, Këshilltar Juridik në Kuvendin e Shqipërisë.
- duke mos u përfshirë nga ana ime si të vlefshme për efekt të këtij kandidimi periudhat e punësimit tim pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor e Decentralizimit dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, periudha që gjejnë pasqyrim në shënimet e librezës sime të punës.

Në vijim, duke ju referuar përmbajtjes së emailit të dërguar nga ana juaj në datë 30.05.2025 lidhur me nevojën e arsyetimit të plotësimit të kriterit të parashikuar në nenin 7/a, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar, specifikisht në kuptim të termit "jurist i nivelit të parë në administratën publike", bazuar në ecurinë e përvojës sime të punës, ju parashtroj sa më poshtë.

Me vendimin e Kuvendit nr. 82, datë 17.06.2017 "Për përzgjedhjen në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'", jam zgjedhur të ushtroj funksionin kushtetues të Komisionerit Publik në procesin e lartpërmendur. Në zbatim të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 7, 8 dhe 9 të ligjit nr. 84/2016, kandidatura ime për pozicionin e Komisionerit Publik u verifikua dhe u përzgjedh përgjatë procedurave kushtetuese dhe ligjore, ku përfshiheshin disa institucione si Avokati i Popullit, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, komisioni ad hoc parlamentar për verifikimin e kandidatëve, komisioni ad hoc parlamentar për përzgjedhjen e kandidatëve dhe seanca plenare e Kuvendit. Referuar përmbajtjes së dispozitës së pikës 1, shkronja "b" dhe pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, në një interpretim autentik të ligjit nga ana e Kuvendit, **kandidatura ime për Komisioner Publik u përzgjedh duke u verifikuar plotësimi i kriterit të përvojës së punës për një periudhë prej 10 vitesh si [...] gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës [...].**

Nga momenti i përzgjedhjes prej Kuvendit në datë 17.06.2017 kam ushtruar funksionin kushtetues të Komisionerit Publik deri në përfundim të mandatit të plotë të parashikuar nga neni 179/b i Kushtetutës, në datë 31.12.2024, për një kohëzgjatje prej 7 vitesh, 6 muaj

e 13 ditë. Funksioni kushtetues i Komisionerit Publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, si mbrojtës i interesit publik përpara gjykatës së këtij procesi, Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kolegji i dytë i Gjykatës Kushtetuese, sikundër statusi i anëtarit të Gjykatës së Lartë që Kushtetuta i garanton Komisionerit Publik gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të konsiderohet si përvojë pune e përshtatshme për sa kërkohet të plotësohet dispozita e nenit 7/a, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar.

Duke vijuar referencën në kërkesën tuaj për interpretim, bazuar në shënimet e organeve përkatëse në librezën e punës, në jetëshkrimin tim ju mund të verifikoni të pasqyruar faktin se në periudhat (i) 21 shkurt 2006 – 20 maj 2013 dhe (ii) 20 maj 2013 – 20 qershor 2013, unë kam ushtruar funksionin përkatësisht të (i) ndihmësit ligjor të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe (ii) këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese, për një kohëzgjatje prej 7 vitesh e 4 muaj.

Të dyja këto funksione, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë (sot i ekuivalentuar me emërtimin këshilltar ligjor) dhe këshilltari ligjor në Gjykatën Kushtetuese, nga vetë ligjvënësi janë konsideruar të tilla që plotësojnë kriterin e përvojës në punë nga ana

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, sa kohë në pikën 3, shkronja "b" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar, parashikohet se plotësimi i kriterit të vjetërsisë në punë ndër të tjera vlerësohet referuar [...] përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës së Lartë [...].

Ky interpretim është pjesë e argumentimit të vendimeve edhe nga vetë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, gjatë procedurave për zgjedhëse të zhvilluara ndër vite. Sikundër keni konstatuar më tej, në përvojën time të punës, gjen pasqyrim edhe periudha e punësimit 26 Nëntor 2013 – 14 shtator 2015 për një kohëzgjatje prej 1 viti, 9 muaj e 18 ditë në funksionin e “këshilltarit jurist” pranë Shërbimit Juridik, pranë Shërbimit Legjislativ të Kuvendit të Shqipërisë, shërbime të parashikuara nga Kushtetuta, si të nevojshme për funksionimin e organit ligjvënës.

Bashkëlidhur këtij parashtrimi, ju do të mund të gjeni aktin “Vërtetim” nr. 02 prot., datë 02.06.2025 të lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë, ku pasqyrohet fakti se gjatë të gjithë periudhës së punësimit në Kuvendin e Shqipërisë, unë kam qenë i caktuar për ushtrimin e funksionit si “këshilltar jurist” pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit të përherëshëm parlamentar, ka në fushën e tij të përgjegjësisë: (i) kodet dhe organizimin e pushtetit gjyqësor, (ii) administratën publike, (iii) administratën e pushtetit gjyqësor, (iv) organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, (v) shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe (vi) të drejtat e njeriut.

Gjatë përvojës sime në funksionin e “këshilltarit jurist” pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, brenda fushës së përgjegjësisë së këtij komisioni, kam përmbushur në vijimësi detyrat e parashikuara për “këshilltarin jurist”, në nenin 19 të Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, duke dhënë ndër të tjera mendime, në formë të shkruar për probleme të karakterit: (i) procedural, (ii) kushtetues, (iii) të të drejtave dhe lirive të njeriut, (iv) të teknikës legislative dhe (v) për afrimin e legjislacionit për projektligjet dhe projektvendimet që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend, akte që i drejtohen: (i) Kryetarit të Kuvendit, (ii) Sekretarit të Përgjithshëm, (iii) Kryetarit të Komisionit parlamentar dhe (iv) deputetëve.

Nisur nga fusha e përgjegjësisë së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në funksionin e “këshilltarit jurist” të këtij komisioni kam shqyrtuar dhe analizuar bazueshmërinë kushtetuese, harmonizimin me korpusin ekzistues të së drejtës dhe kam përgatitur në vijimësi: (i) relatimet dhe (ii) raportet e këtij Komisioni, duke formuluar njëkohësisht dhe amendime për projektligjet që propozoheshin për miratim, projektligje këto që lidheshin me sistemin e drejtësisë, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, e ku ndër dhjetëra të tillë mund të përmendja iniciativat legislative për miratimin e Kodit të Procedurave Administrative, ndryshime në kodet ekzistuese apo ndryshime në ligjet organike të institucioneve të fushës.

Për shkak të nivelit të lartë të përgatitjes profesionale, eksperiencës brenda sistemit të drejtësisë dhe njohjes së thelluar të së drejtës, për nevojat në çështje të veçanta, kam asistuar po ashtu në cilësinë e “**këshilltarit jurist**” edhe në struktura të tjera të posaçme të Kuvendit, si Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, kryesuar

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

nga Kryetari i Kuvendit, kur ky i fundit trajtonte kërkesat procedurale që paraqiteshin nga institucionet përkatëse të parashikuara në ligj.

Sikundër kam parashtruar edhe në jetëshkrimin tim, përpos sa më lart, në funksionin e “**këshilltarit jurist**” kam kontribuar po ashtu në: (i) përgatitjen e projektakteve dhe relacioneve shoqëruese, të paraqitura si iniciativa legislative të deputetëve; (ii) përgatitjen e akteve të nevojshme gjatë përfaqësimit të Kuvendit në gjykimet para Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Shkallës së Parë; (iii) përgatitjen, me Nismën e Integritimit Evropian të Kuvendit, të raporteve periodike mbi vlerësimin e legjislacionit në sistemin e drejtësisë në kuadër të raportimeve pranë Komisionit të BE-së; (iv) hartimin e Kodit Etik të Kuvendit.

Nënvizoj, se përgjatë periudhës së punësimit në Kuvendin e Shqipërisë, u ngrit dhe zhvilloi veprimtarinë e tij Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Nisur nga funksioni që ushtroja si “këshilltar jurist”, me vendimin nr. 12, datë 02.04.2015 të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë (gjeni kopje bashkëlidhur këtyre parashtrimeve), jam caktuar në cilësinë e koordinatorit pranë Sekretariatit Teknik, të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Përgjatë periudhës së angazhimit edhe në këtë detyrë, kam ideuar, përgatitur dhe realizuar një sërë aktesh në funksion të hartimit të dokumentit analitik dhe planit të veprimit të Komisionit të Posaçëm në fushën e strategjisë antikorruption, që u finalizua me miratimin e ligjeve përkatëse.

Thënë sa më lart, nisur edhe nisur edhe nga qëndrime të mëparshme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përvoja e punësimit për një kohëzgjatje prej 1 viti, 9 muaj e 18 ditë si “këshilltar juridik” pranë Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut duhet të konsiderohet si përvojë pune e përshtatshme, për sa kohë kërkohet të plotësohet dispozita e nenit 7/a, pika 2, e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar.

Në vijim, duke marrë në konsideratë edhe një qasje formaliste që interpretimin e terminologjisë së juristit të nivelit të lartë në administratën publike mund ta referojë në kategorizimin që legjislacioni organik mbi nëpunësin civil parashikon për këtë kategori punonjësish të administratës publike, sjell në vëmendjen tuaj se me miratimin nga ana e Këshillit të Ministrave të vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabinetit në disa institucione të Administratës Publike”, si dhe me vendimin nr. 54, datë 26.06.2023 “Për kategorizimin e pozicioneve të punës dhe klasave të nëpunësve të administratës së Kuvendit”, Byroja e Kuvendit të Shqipërisë, organ i pavarur kushtetues, në kategorizimin e pozicioneve të punës për nëpunësit e administratës së Kuvendit, ka ekuivalentuar pozicionin dhe pagën e “këshilltarit juridik/shërbimi” me kategorinë I, klasa I.5, që në interpretim të nenit 19 “Klasifikimi”, kreu III “Klasifikimi i pozicioneve në Shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, i përket kategorisë së nëpunësve të lartë drejtues.

Sërish, referuar kërkesës suaj, bazuar në shënimet e organeve përkatëse në librezën e punës, në jetëshkrimin tim ju mund të verifikoni të pasqyruar faktin se në periudhat (i) 30 mars 2004 – 16 mars 2005 dhe (ii) 16 mars 2005 – 1 maj 2005, unë kam ushtruar detyrat përkatësisht të (i) këshilltarit dhe (ii) drejtorit të kabinetit të Ministrit të Drejtësisë, për një kohëzgjatje prej 1 viti e 1 muaji.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Dëshiroj të nënvizoj se objekti i gjerë i veprimtarisë dhe fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë ndër vite gjenin rregullim të posaçëm në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, i ndryshuar, nisur edhe nga kompetencat e gjera që i njiheshin kësaj ministrie në sistemin e drejtësisë, deri në miratimin e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016.

Gjatë periudhës në të cilën kam qenë pjesë dhe kam drejtuar kabinetin e Ministrit të Drejtësisë, sikundër kam parashtruar në jetëshkrimin tim, për shkak të funksionit dhe ndarjes së detyrave, kam kontribuar në (i) përgatitjen e opinioneve ligjore mbi çështje të veprimtarisë institucionale në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë; (ii) bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë; (iii) koordinimin e ushtrimit të përgjegjësisë nga ana e drejtorive dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë; dhe në (iv) verifikimin e saktësisë, nga aspekti formal dhe ligjor, të materialeve të trajtuara nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë përpara nënshkrimit të tyre nga Ministri i Drejtësisë.

Ka qenë po ashtu, ndër të tjera, pjesë e përgjegjësisë sime funksionale edhe bashkëpunimi me ekspertë ndërkombëtarë të fushës, në hartimin e të parit kuadër ligjor për goditjen e krimit të organizuar, të materializuar me miratimin e ligjit nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

Gjatë kësaj periudhe punësimi, kam qenë pjesë e sekretariatit teknik të Komisionit të Reformës Ligjore (KRL), organ këshillimor ekspertësh pranë Ministrisë së Drejtësisë, krijuar me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave (termin kushtetues i kohës). Në këtë cilësi, kam kontribuar në grupet e punës për hartimin e projektakteve ligjore, brenda objektit të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë.

Në të tilla rrethana, nisur edhe nga qëndrime të mëparshme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, periudha e punësimit për një kohëzgjatje prej 1 viti e 1 muaji si (i) këshilltar dhe (ii) drejtor i kabinetit të Ministrit të Drejtësisë duhet të konsiderohet si përvojë pune e përshtatshme, për sa kohë kërkohet të plotësohet dispozita e nenit 7/a, pika 2, e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar.

Edhe në këtë rast, duke marrë në konsideratë edhe një qasje formaliste që interpretimin e terminologjisë së juristit të nivelit të lartë në administratën publike prirret ta referojë në kategorizimin që legjislacioni organik mbi nëpunësin civil parashikon për këtë kategori punonjësish të administratës publike, sjell në vëmendjen tuaj se me miratimin nga ana e Këshillit të Ministrave të vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabinetit në disa institucione të administratës publike”, pozicioni dhe paga e “drejtorit të kabinetit të ministrit” përfshihet në kategorinë I, klasa I.3, kurse pozicioni dhe paga e “këshilltarit të ministrit” përfshihet në kategorinë I, klasa I.4, e që në interpretim të nenit 19 “Klasifikimi”, kreu III “Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, të dyja këto klasifikime i përkasin kategorisë së nëpunësve të lartë drejtues.

Ndërkohë, dëshiroj t’ju bëj me dije se periudhën e punësimit 15 gusht 2001 – 19 korrik 2002, si “këshilltar ligjor” pranë ICMC (International Catholic Migration Commission), organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse me qendër në Gjenevë, Zvicër, e kam përfshirë në jetëshkrimin tim për efekt të këtij kandidimi, si një vlerë të shtuar në angazhimin tim në fushën e të drejtave të njeriut, referuar dispozitës së nenit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

7/a, pika 2, e ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar, për shkak se në atë periudhë punësimi pata mundësinë të përfshihem në grupe pune që hartuan korpusin e akteve nënligjore, të miratuara në zbatim të ligjit nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në të njëjtin kontekst, sjell në vëmendjen tuaj se, sikurse kam parashtruar në kërkesën time për kandidim, gjatë periudhës shkurt 2008 – shkurt 2011 kam qenë në cilësinë e pedagogut të jashtëm në IJPAL “Justiniani I”, për lëndën “E Drejta Penale”, pjesa e përgjithshme, ku përgjatë këtyre viteve kam trajtuar institutet kryesore të së drejtës penale, që reflektojnë gjerësisht liritë dhe të drejtat e njeriut të njohura e të sanksionuara nga dispozitat e Kushtetutës.

Në përfundim të këtij parashtrimi, referuar përvojës sime të punës me: (i) kohëzgjatje prej 7 vitesh, 6 muajsh e 13 ditësh si Komisioner Publik; (ii) kohëzgjatje prej 7 vitesh e 4 muajsh si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë dhe këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese; (iii) kohëzgjatje prej 1 viti, 9 muajsh e 18 ditësh si këshilltar jurist pranë Komisionit për Çështjen Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit; (iv) kohëzgjatje prej 1 viti e 1 muaji si këshilltar dhe Drejtor Kabineti i Ministrit të Drejtësisë, vlerësoj se kandidatura ime plotëson kriterin e përvojës profesionale, sipas parashikimeve të nenit 7/a, pika 2 të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar....”.

49. Për sa më lartë, në zbatim të pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton i provuar fakti se kandidati Florian Ballhysa ka përafërsisht 19 vite vjetërsi pune në tërësi. Konkretisht, për periudhat e saktësuara si më poshtë:

15.gusht.2001 – 19.korrik.2002, ICMC-Këshilltar Ligjo, 11 muaj, 4 ditë.

27.gusht.2002 – 20.tetor.2002, Sekretar i Zëvendësministrit Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, 1 muaj 24 ditë.

23.tetor 2002 - 12.shkurt.2003, Sekretar i Zëvendësministrit, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, 3 muaj, 20 ditë.

30.mars 2004 – 16.mars 2005, Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë, 11 muaj, 17 ditë.

16. mars.2005 – 01.maj.2005, Drejtor i Kabinetit të Ministrit, 1 muaj, 15 ditë.

21.shkurt 2006 – 20.maj.2013, Ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, 7 vite, 2 muaj, 29 ditë.

20.maj.2013 – 20.qershor.2013, Këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese, 1 muaj.

26.nëntor.2013 - 14.shtator.2015, Këshilltar juridik në Kuvendin e Shqipërisë, 1 vit, 9 muaj, 19 ditë.

17.qershor.2017 – 31.dhjetor.2024, Komisioner Publik, në Institucionin e Komisionerëve Publik, 7 vite, 6 muaj, 14 ditë.

IV. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

47. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidatit Florian Ballhysa për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

48. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj”.

49. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

50. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 766/5 prot., datë 18.04.2025 ka përcjell aktin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, Florian Ballhysa për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, me nr. 17/23 prot, datë 18.04.2025, ku është konkluduar për kandidatin Florian Ballhysa.

51. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Florian Ballhysa, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- ç) Nuk ka kryer deklaram të rremë.
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

52. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaramet e bëra nga kandidati Florian Ballhysa pranë ILDKPKI me Deklaratën e e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

53. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Florian Ballhysa.

54. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Florian Ballhysa ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, kjo kandidate nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

55. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati Florian Ballhysa ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

56. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr.206/11 prot., datë 12.02.2025, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: *“...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim për shtetasit e tjerë të cituar në shkresën tuaj, nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO”*.

57. Në vijim Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit me shkresën nr.206/2 prot., datë 05.02.2025, ka bërë me dije, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, se: *“...Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimin e thelluar të të dhënave të vetëdeklaruar në formularin e plotësuar nga subjekt të këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi përgjegjës, për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, vetëm për rastet kur ky i fundit, pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak të të dhënave, konstaton se:*

-subjekti/personi nuk ka deklaruar në formular asnjë fakt që ka të bëjë me të kaluarën e tyre penale, por ka indicie mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me....

-subjekti/personi ka deklaruar në formular të dhëna që kanë të bëjnë me rrethanat/faktet e sipërpërmendura dhe se prima facia të dhënat nuk përfshihen brenda

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, por e kalon rastin për kontroll të thelluar, për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve, sipas ligjit;

-ka kërkesë të bërë pranë tij, si organ kompetent për verifikim të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Sipas kësaj dispozite, për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, të drejtën e nismës për të kërkuar verifikimin e të dhënave, pranë organit kompetent për verifikim, sipas këtij ligji, e ka 1/10 e deputetëve, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Prokurori i Përgjithshëm.

Në këtë rast, organi përgjegjës dhe kompetent, për administrimin e formularit dhe verifikimin paraprak të të dhënave, në kërkesën për verifikim të thelluar specifikon subjektin e nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 që ka kërkuar verifikimin dhe të dhënat, faktet apo rrethanat që përmban kërkesa e tij e që përbëjnë shkak për zbatimin e këtij ligji.....Për sa më sipër, mbështetur në nenet 44, 62 e 64 të Kodit të Procedurave Administrative, ju kërkohet plotësimi i pasaktësive/ të metave brenda njëzetë ditëve. Mosplotësimi i tyre brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës". Në vijim të shkresës nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025 të Prokurorisë së Përgjithshme, është përcjell nga ky institucion me shkresën nr. 206/17 prot., datë 07.03.2025, vendimi i datës 07.03.2025 "Për mospranimin e kërkesës" ku është vendosur:

"1. Mospranimin e kërkesës nr.66 prot., datë 31.01.2025, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për verifikimin e plotë të të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit datë 20.01.2025 në zbatim të ligjit nr. 138/2015, nga Florian Enver Ballhysa, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

2. Ky vendim t'i njoftohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kundër të cilit mund të ankohet sipas procedurës së parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative".

58. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka informuar se: "...rezultojnë pa shënime në sistem...".

59. Gjithashtu Prokuroria e Përgjithshme, ka përcjell shkresën nr.206/44 prot., datë 29.04.2025, lidhur me të gjithë informacionin e ardhur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore me Juridiksion të Përgjithshëm, ku në thelb rezulton se: "... nuk rezulton të kenë çështje penale në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë...".

60. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr. 73 prot., datë 31.01.2024, Drejtoria e Përgjithshme të Gjendjes Civile e cila me shkresën nr. 1166/1 prot., datë 12.02.2025, ka kthyer përgjigje se: "Nuk ka ndryshime".

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

61. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr. 68 prot., datë 31.01.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 543/4 prot., datë 10.02.2025, ka informuar se: “Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasit.... nuk janë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë veprë penale; nuk figurojnë të regjistruar me identitet tjetër; nuk rezultojnë të kthyer deportiv apo të dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër; nuk rezulton të kenë urdhër kërkimi ndërkombëtar nga ndonjë autoritet gjyqësor i huaj”;

62. Lidhur sa më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresat nr. 75 prot., - nr. 91 prot., datë 31.01.2025, ka kërkuar informacion pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Lartë, të cilat me shkresa respektive kanë referuar në thelb se: “nuk rezulton që të ketë të regjistruar çështje penale në emër të shtetasit Florian Ballhysa”.

63. Në vijim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me shkresën nr. 71 prot., datë 31.01.2025, i ka kërkuar informacion dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim SPAK), e cila, me shkresën nr. 7717 prot., datë 28.02.2025, ka kthyer përgjigje se:

“Në përgjigje të shkresës suaj, me nr.71 prot, datë 31.01.2025, ardhur dhe protokolluar më datë 03.02.2025, ju konfirmojmë se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e procedimeve penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, **nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim** të kandidatëve të mëposhtëm, të cilët do të përfshihen në shortin për zgjedhjen si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese:.... 5. Kandidat Florian Enver Ballhysa, datëlindja 23.12.1978, nr. ID H81223099U...”.

Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e kallzimeve.. Në lidhje me shtetasin Florian Ballhysa, rezultojnë këto të dhëna:

- Ndaj shtetasit Florian Ballhysa, është regjistruar kallzimi Nr.38 i vitit 2022, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr.41, viti 2022, për veprat penale të parashikuara nga nenet 180 dhe 248, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar.

Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin Nr.31/152, vendimi, datë 16.02.2023, ka vendosur pushimin e procedimit Nr.41, viti 2022.

- Ndaj shtetasit Florian Ballhysa, është regjistruar kallzimi Nr.63 i vitit 2022, për të cilin pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal me Nr.64, viti 2022, për veprat penale të parashikuara nga nenet 180 dhe 248, të K.Penal, pa asnjë emër të regjistruar.

Pas kryerjes së hetimeve të procedimit penal Nr.64, viti 2022 është vendosur bashkimi i këtij procedimi penal në një procedim të vetëm me numrin 41, viti 2022.

64. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Florian Ballhysa ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

65. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 308/5 prot., datë 14.02.2025, ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 71, datë 13.02.2025, me të cilën është konkluduar se: “ , z. Florian Ballhysa,.. për shkak të moshës së tyre nën 14 vjec përpara datës 2 korrik 1991 si datë fundore e zbatimit të ligjit 45/2015, nuk janë subjekte verifikimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit ër Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar”.

66. Nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se kandidati Florian Ballhysa, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

67. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar sot Autoritetit Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, sot Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, nëse kandidati Florian Ballhysa “ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

68. Autoriteti Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 1342 prot., datë 12.03.2025 ka evidentuar se: “Në përfundim të procedurave të verifikimit, autoritetet verifikuese na informojnë se nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e z. Florian Enver Ballhysa, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme. Për kandidatin e lartpërmendur, janë aplikuar standardet e parashikuara në nenin 38 “Standardet e kontrollit të figurës, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

69. Ndërsa, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, sot Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, me shkresën nr. 658/1 prot., datë 11.02.2025, ka informuar se: “Nuk ka të dhëna për kontakte apo lidhje të tyre me persona të papërshtatshme, apo të përfshirë në krimin e organizuar”.

70. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidati Florian Ballhysa nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

71. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, i ndryshuar, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Florian Ballhysa në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet ku kandidati ka ushtruar funksione publike.

72. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Florian Ballhysa ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1997 - 2001 si “Jurist”, në Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Në vijim gjatë periudhës 2005-2008 ka përfunduar studimet Master në Studime Evropiane pranë Shkollës Pauniversitare të Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës. Në zbatim të nenit 75 dhe 124 të ligjit nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

73. Në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Florian Ballhysa ka ushtruar veprimtari profesionale si :

21.shkurt 2006 – 20.maj.2013, Ndhmës ligjor në Gjykatën e Lartë, 7 vite, 2 muaj, 29 ditë.

20.maj.2013 – 20.qershor.2013, Këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese, 1 muaj.

26.nëntor.2013 - 14.shtator.2015, Këshilltar juridik në Kuvendin e Shqipërisë, 1 vit, 9 muaj, 19 ditë.

17.qershor.2017 – 31.dhjetor.2024, Komisioner Publik, në Institucionin e Komisionerëve Publik, 7 vite, 6 muaj, 14 ditë.

74. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit si ndhmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, Këshilli çmon këtë përvojë profesionale të vlefshme për efekt kandidimi. Në këtë kuadër, sillen në vëmendje dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë statusin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Në ligjin nr.8588, datë 15.3.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës së lartë të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar (*tashmë i shfuqizuar nga ligji nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*), parashikohet:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Neni 7 “Kryetari i Gjykatës së Lartë”: “Kryetari i Gjykatës së Lartë kryen këto detyra: “..ç) Emëron dhe shkarkon ndihmësit ligjorë.....”

Neni 20 “Ndhmësit ligjorë”: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka deri në dy ndihmës ligjorë dhe personin e shërbimit. Ndhmësit ligjorë përzgjidhen nga vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ndërmjet juristëve që plotësojnë kushtet ligjore për t’u emëruar gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit. Ata emërohen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë. Ndhmësit ligjorë përfitojnë përkatësisht pagën e gjyqtarit të shkallës së parë ose të gjykatës së apelit...”

Neni 21 “Detyrat e ndihmësit ligjorë”: “Ndhmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme, si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë”.

75. Sa i përket përvojës profesionale të kandidatit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në vijim të parashtimeve të kandidatit të sipërcituara, vlerësohet se kjo përvojë profesionale është e vlefshme për efekt kandidimi. Nisur nga aktet e përcjella prej Kuvendit, konstatohet se me vendimin e datës 28.04.2015, me nr. 1325 prot., kandidati është konfirmuar si nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese në detyrë “këshilltar juridik” në Shërbimin Juridik pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Sikurse rezulton nga vërtetimi nr. 02, datë 02.06.2025 të Kuvendit, gjatë periudhës së punësimit të tij, kandidati ka ushtruar detyrën e “Këshilltarit Jurist” pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe sikurse ka deklaruar edhe vetë kandidati, pjesë e fushës së përgjegjësisë së tij ka qenë (i) përgatitja e projektakteve dhe relacioneve shoqëruese, të paraqitura si iniciativa legislative të deputetëve; (ii) përgatitja e akteve të nevojshme gjatë përfaqësimit të Kuvendit në gjykimet para Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Shkallës së Parë; (iii) përgatitja, me Nismën e Integritimit Evropian të Kuvendit, të raporteve periodike mbi vlerësimin e legjislacionit në sistemin e drejtësisë në kuadër të raportimeve pranë Komisionit të BE-së; (iv) hartimi e Kodit Etik të Kuvendit. Gjithashtu Këshilli mban në konsideratë parashikimet e nenit 18 19 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku përcaktohen kompetencat e Komisioneve të përhershme, Nënkomisioneve e Kuvendit.

Po ashtu, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, provohet se kandidati me vendimin nr. 12, datë 02.04.2015 të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë është caktuar në cilësinë e Koordinatorit pranë Sekretariatit Teknik, të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Bashkëlidhur shpjegimeve dhe provave përcjell nga kandidati, gjenden akte provuese në lidhje me statusin e “Këshilltarit Juridik” në Shërbimin Juridik të Kuvendit, nga të cilat rezulton se në mbështetje të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabinetit në disa institucione të Administratës Publike”, ka dal vendimi nr. 54, datë 26.06.2023 “Për kategorizimin e pozicioneve të punës dhe klasave të nëpunësve të administratës së Kuvendit”, i Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë, mbi kategorizimin e pozicioneve të punës për nëpunësit e administratës së Kuvendit, duke kategorizuar pozicionin dhe pagën e “Këshilltarit Juridik/Shërbimi” me kategorinë I, klasa I.5. Sa më sipër, vlerësohet se kontributi profesional i kandidatit pranë një organi kushtetues si Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, është në përputhje me standardin e kërkuar nga neni 7/a, i ligjit nr. 8577/2000 “jurist i nivelit të lartë në administratën publike”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

76. Po ashtum përvoja profesionale disa vjeçare e kandidatit si Komisioner Publik, në Institucionin e Komisionerëve Publik, është plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 7/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, të KED.

77. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën 76-79 më sipër, duke patur në konsideratë përvojën profesionale të kandidatit si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, si këshilltar juridik pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Komisioner Publik pranë institucionit të Komisionerëve Publik, Këshilli konstaton se kandidati Florian Ballhysa ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

78. Në pikën 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në të cilën përcaktohet që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se, *kandidati Florian Ballhysa nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji*. Nga të dhënat e konstatuara, rezulton se kandidati ka mbajtur poste me natyrë politike si Drejtori i Kabinetit të Ministrit të Drejtësisë (viti 2005) dhe Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë (viti 2004-2005), por periudha e ushtrimit të këtyre funksione është tej periudhës së parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, si ndalim ligjor, për rrjedhojë kandidati Florian Ballhysa nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

79. Gjithashtu, në pikën 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse dhe nga formulari i vetëdeklarimit të paraqitur nga kandidati Florian Ballhysa, Këshilli konstaton se, *kandidati nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji*. Për rrjedhojë kandidati Florian Ballhysa nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

80. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati Florian Ballhysa nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidati Florian Ballhysa nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

81. Për sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Florian Ballhysa, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/ç të ligjit nr. 8577/2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, të nenit 229, 235, 236, 237 të ligjit nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, si edhe pikave 17, 25, 26, 33, 57, 58, 79, 91 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Florian Ballhysa, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Florian Ballhysa.
3. Kandidati Florian Ballhysa ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTAR

Zv/KRYETARE

KRYETAR

Ilir Toska

Marjana Semini

Sokol Sadushi

ANËTARE

ANËTARE ZËVENDËSUESE

ANËTARE

Alma Muça

Elvana Çiçolli

Enkela Vlora

ANËTARE

ANËTAR ZËVENDËSUES

ANËTAR ZËVENDËSUES

Irma Balli

Genti Xholi

Bezart Kaçkini

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**